VENDIM
Nr. 9/2023

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT ME KOHË JO TË PLOTË PUNE, QË REKRUTOHET PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË PILOTIMIT TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2023, TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 19, shkronja "m", të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miratuar në datën 16.2.2023.

Lidhja 1

Drejtoria	**Pozicioni punës**	**Kategoria e pagës**	**Periudha**	**Nr. i punonjësve**	**Kriteret e punësimit**
Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit	Specialist PEVN	IV-b	3 muaj	14	Arsim i lartë/Informatikë/ TIK/Shkenca Kompjuterike.
	Operatorë PEVN	V	3 muaj	24	Arsim i detyruar
	TOTAL			**38**	